



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



MANUAL PËR KYÇJE NË SISTEMIN DMSA DHE RESETIM TË FJALËKALIMIT

Besnik Dragusha

Prishtinë, APK, mars 2026

PËRMBAJTJA:

1. SISTEMI DMSA	3
1.1. MODULI PËR DEKLARIMIN ONLINE TË PASURISË	3
1.1.1. Kyçja në platformën e-deklarimi	3
1.1.2. Resetimi i Fjalëkalimit në platformën e-deklarimi.....	7
1.2. MODULI PËR ZYRTARËT KONTAKTUES – PIKAT E KONTAKTIT PËR DEKLARIM TË PASURISË.....	9
1.2.1. Kyçja në platformën Pikat Kontaktuese.....	9
1.2.2. Resetimi i Fjalëkalimit në platformën Pikat Kontaktuese.....	13

LISTA E FIGURAVE:

Figura 1. Dritarja e qasjes në sistem të deklarimit të pasurisë, e-deklarimi	4
Figura 2. Verifikimi përmes reCAPTCHA si masë e sigurisë	5
Figura 3. Hapi i fundit në kyçje – klikimi i butonit Kyçu.....	6
Figura 4. Dritarja e kyçjes – Linku për resetim të fjalëkalimit	7
Figura 5. Dritarja për Resetimin dhe dërgimin e një fjalëkalimi të ri në email.....	8
Figura 6. Dritarja e qasjes në modulën Pikat Kontaktuese.....	10
Figura 7. Verifikimi përmes reCAPTCHA si masë e sigurisë	11
Figura 8. Hapi i fundit në kyçje – klikimi i butonit Kyçu.....	12
Figura 9. Dritarja e kyçjes – Linku për resetim të fjalëkalimit	13
Figura 10. Dritarja për Resetimin dhe dërgimin e një fjalëkalimi të ri në email.....	14

1. SISTEMI DMSA

DMSA (*Data Managment System of the Agency for Prevention of Corruption*) është sistem elektronik i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, i cili është i përberë prej disa moduleve dhe platformave elektronike, të cilat përdoren nga stafi i APK-së, zyrtarët kontaktues, subjektet deklaruese për realizimin e proceseve të punës në mënyrë elektronike.

1.1. MODULI PËR DEKLARIMIN ONLINE TË PASURISË

Moduli për deklarimin online të pasurisë është platformë elektronike, që përdoret për realizimin e deklarimit të pasurisë nga subjektet deklaruese. Ky modul është i njohur edhe si e-deklarimi, dhe vegëza për qasje në të është <https://e-deklarimi.rks-gov.net>

1.1.1. Kyçja në platformën e-deklarimi

Kyçja në sistemin elektronik për deklarimin e pasurisë, e-deklarimi, bëhet duke kaluar nëpër 6 hapa të shpejt, si:

- **Hapi 1:** Në njërën nga browseret e kompjuterit tuaj (p.sh.: Google Chrome, Microsoft Edge, Mozilla, apo Safari) hapeni linkun <https://e-deklarimi.rks-gov.net> me ç'rast do të shfaqet dritarja si në figurën 1, dritarja e qasjes.
- **Hapi 2:** Në pjesën për shkrim të userit, boksi Numri Personal, shkruajeni numrin personal të letërnjoftimit tuaj prej 10 shifrave, si p.sh.: 1000000001, të subjektit deklarues
- **Hapi 3:** Në kutinë e Fjalëkalimit, jepini fjalëkalimin (passwordin) me të cilin jeni qasur në herën e fundit në sistem të deklarimit. Nëse jeni deklarues për herë të parë, atëherë, këtu duhet të shkruhet fjalëkalimi që keni pranuar në email të dërguar nga sistemi me rastin e regjistrimit tuaj si subjekt deklarues nga zyrtari kontaktues i institucionit tuaj.
- **Hapi 4:** Kliko me maus mbi kutinë e zbrazët para fjalisë (I'm not a robot)






Figura 1. Dritarja e qasjes në sistem të deklarimit të pasurisë, e-deklarimi

- **Hapi 5:** Ky hap paraqitet në herën e parë të qasjes në një pajisje (Figura 2, nën a), ku duhet të përzgjidhen fotot sipas kërkesës dhe të klikohet butoni **“Verify”**, si në Figurën 2 nën b. Herëve të tjera nuk shfaqet ky hap, por kalohet në **hapi 6**.

Hapi 5



a)



b)

Figura 2. Verifikimi përmes reCAPTCHA si masë e sigurisë

- **Hapi 6:** Klikoni butonin “Kyçu”, si në figurën 3, dhe ju do të kyçeni në sistem të deklarimit elektronik të pasurisë.

Shqip



AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIA ZASPREÇAVANJE KORUPCIE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

E-Deklarimi

Numri personal

Fjalëkalimi

[Reseto fjalëkalimin](#)

☒ I'm not a robot

 reCAPTCHA
[Privacy](#) - [Terms](#)

Kyçu

Hapi 6

Figura 3. Hapi i fundit në kyçje – klikimi i butonit Kyçu

1.1.2. Resetimi i Fjalëkalimit në platformën e-deklarimi

Në rast se keni harruar fjalëkalimin tuaj në platformën e-deklarimi, atë mund ta resetoni vetë, duke kaluar në dy hapa të vetëm, dhe atë kështu:

Hapi 1: Në dritaren për kyçje në platformën e-deklarimi, klikoni në fjalinë **“Reseto fjalëkalimin”** si në figurën 4. Me këtë rast do të hapet dritarja për resetim të fjalëkalimit si në figurën 5.

Figura 4. Dritarja e kyçjes – Linku për resetim të fjalëkalimit

Hapi 2: Në dritaren që është hapur tani: Shkruani numrin tuaj personal të letërnjoftimit dhe email adresën të cilën e keni të regjistruar në sistem. Që të dy këto të dhëna duhet të jenë të shkruara saktë, dhe klikoni butonin “Dërgo email” (si në figurën 5). Nëse ju keni vendosur saktë numrin personal dhe email adresën, atëherë sistem në emailin tuaj ju dërgon një fjalëkalim të ri, me të cilin ju mund të qaseni në sistem. Nëse njëjërën nga këto dy të dhëna i keni dhënë gabim, sistemi ju informon se dërgimi i emailit ka dështuar.

1. Shkruaje numrin tuaj personal 10 shifror të letërnjoftimit, si p.sh. 1000000001

2. Shkruaje email adresën që e keni të regjistruar në sistem të deklarimi, si p.sh. filan.fisteku@rks-gov.net

3. Kliko butonin "Dërgo email"

Keni harruar fjalëkalimin

Numri personal *

1000000001

Email adresa *

filan.fisteku@rks-gov.net

Ju do të merrni një email nga ku mund të resetoni fjalëkalimin tuaj.

Dërgo email

< Kthehuni tek Kycja

DEKLARIMI I RREGULLT VIETOR (DRV)

Nga 1 deri më 31 mars për vitin paraprak

Periudha nga 1 janar deri më 31 dhjetor

Pas DMD mbulon vetëm periudhën e mbetur

Figura 5. Dritarja për Resetimin dhe dërgimin e një fjalëkalimi të ri në email

VËNI RE: Nëse ju nuk e dini se çfarë emaili keni të regjistruar në sistem, kontaktojeni zyrtarin kontaktues në institucionin tuaj dhe, ai do t'iu informoj se cili është emaili i juaj i regjistruar në sistem të deklarimit. Po ashtu, edhe ndryshimin e emailit tuaj në sistem do ta bëjë zyrtari kontaktues.

1.2. MODULI PËR ZYRTARËT KONTAKTUES – PIKAT E KONTAKTIT PËR DEKLARIM TË PASURISË

Moduli për zyrtarët kontaktues të deklarimit të pasurisë, është platformë elektronike, që përdorët për realizimin e regjistrimit, editimit, fshirjes dhe editimit të subjekteve deklaruese nëpër institucione. Ky modul është i njohur edhe si Pikat Kontaktuese të Deklarimit të Pasurisë, dhe vegëza për qasje në te është <https://pikatekontaktit.rks-gov.net>

1.2.1. Kyçja në platformën Pikat Kontaktuese

Kyçja në modulin e sistemin elektronik DMSA, për zyrtarët kontaktues të deklarimit të pasurisë nëpër institucione, Pikat Kontaktuese, bëhet duke kaluar nëpër 6 hapa të shpejt, si:


- **Hapi 1:** Në njërën nga browseret e kompjuterit tuaj (p.sh.: Google Chrome, Microsoft Edge, Mozilla, apo Safari) hapeni linkun <https://pikatekontaktit.rks-gov.net> me ç'rast do të shfaqet dritarja si në figurën 6, dritarja e qasjes.
- **Hapi 2:** Në pjesën për shkrim të userit, boksi Numri Personal, shkruajeni numrin personal të letërnjoftimit tuaj prej 10 shifrave, si p.sh.: 1000000001, të zyrtarit kontaktues.
- **Hapi 3:** Në kutinë e Fjalëkalimit, jepini fjalëkalimin (passwordin) me të cilin jeni qasur në herën e fundit në platformë të Pikat Kontaktuese. Nëse jeni regjistruar si zyrtarë kontaktues për herë të parë, atëherë, këtu duhet të shkruhet fjalëkalimi që keni pranuar në email të dërguar nga sistemi me rastin e regjistrimit tuaj si zyrtar kontaktues i institucionit tuaj nga zyrtari përgjegjës i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.
- **Hapi 4:** Kliko me maus mbi kutinë e zbrazët para fjalisë (I'm not a robot).




Figura 6. Dritarja e qasjes në modulin Pikat Kontaktuese

- **Hapi 5:** Ky hap paraqitet në herën e parë të qasjes në një pajisje (Figura 7, nën a), ku duhet të përzgjidhen fotot sipas kërkesës dhe të klikohet butoni **“Verify”**, si në Figurën 7 nën b. Herëve të tjera nuk shfaqet ky hap, por kalohet drejtpërdrejt në **hapin 6**.

Hapi 5



a)



b)

Figura 7. Verifikimi përmes reCAPTCHA si masë e sigurisë

➤ **Hapi 6:** Klikoni butonin “Kyçu”, si në figurën 8, dhe ju do të kyçeni në modulën Pikat Kontaktuese.

← → ↻ 📄 pikatekontaktit.rks-gov.net/auth



AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZASPREČAVANJE KORUPCIE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

Pikat Kontaktuese

Numri Personal

 1000000001

Fjalëkalimi



[Reseto fjalëkalimin](#)

 I'm not a robot  reCAPTCHA
Privacy - Terms

Kyçu

Hapil 6

Figura 8. Hapi i fundit në kyçje – klikimi i butonit Kyçu

1.2.2. Resetimi i Fjalëkalimit në platformën Pikat Kontaktuese

Në rast se keni harruar fjalëkalimin tuaj në platformën Pikat Kontaktuese, atë mund ta resetoni vetë, duke kaluar në dy hapa të vetëm, dhe atë kështu:

Hapi 1: Në dritaren për kyçje në platformën Pikat Kontaktuese, klikoni në fjalinë **“Reseto fjalëkalimin”** si në figurën 9. Me këtë rast do të hapet dritarja për resetim të fjalëkalimit si në figurën 10.




Figura 9. Dritarja e kyçjes – Linku për resetim të fjalëkalimit

Hapi 2: Në dritaren që është hapur tani: Shkruani numrin tuaj personal të letërnjoftimit dhe email adresën të cilën e keni të regjistruar në sistem. Që të dy këto të dhëna duhet të jenë të shkruara saktë, dhe klikoni butonin “Dërgo fjalëkalim të ri” (si në figurën 10). Nëse ju keni vendosur saktë numrin personal dhe email adresën, atëherë sistemi në emailin tuaj ju dërgon një fjalëkalim të ri, me të cilin ju mund të qaseni në sistem. Nëse njëherë nga këto dy të dhëna i keni dhënë gabim, sistemi ju informon se dërgimi i emailit ka dështuar.

Hapi 1:
Shkruaje numrin tuaj personal 10 shifror të letërnjoftimit, si p.sh: 1000000001

Hapi 2:
Shkruaje email adresën që e keni të regjistruar në sistem të pikave kontaktuese, si p.sh: filan.fisteku@rks-gov.net

Hapi 3:
Kliko butonin "Dërgo fjalëkalim të ri"

SHËRBIMET E OFRUARA

Shërbimet Kryesore

- Parandalimi i konfliktit të interesit
- Deklarimi i pasurisë dhe dhuratat
- Mbrojtja e sinjalizuesve

Figura 10. Dritarja për Resetimin dhe dërgimin e një fjalëkalimi të ri në email

VËNI RE: Nëse ju nuk e dini se çfarë emaili keni të regjistruar në sistem, kontaktojeni zyrtarin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (zyrtarët e deklaramit të pasurisë) dhe ai do t’iu informoj se cila është emaila e juaj e regjistruar në modulën e Pikave të Kontaktit. Po ashtu, edhe ndryshimin e emailit tuaj në sistem do ta bëjë zyrtari i Agjencisë me këtë rast.